



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CA.nr.1601/2017

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu, kryeses, Hunaida Pasuli e Faton Ademi, anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditëses B. (G.) D., nga ..., Komuna e Pejës, e përfaqësuar nga babai i saj G. D., të përfaqësuar nga B.L., avokat në Pejë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli, në Prishtinë, e përfaqësuar nga Faik Sylejmani, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesave të ndërgjyqësve, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.1148/2015 të datës 20.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.02.2021, jep:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohen**, ankesat e ndërgjyqësve, B. D. dhe BKS, ndërsa paragrafi I. i dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1148/2015 të datës 20.01.2017, për shumën e gjykuar të cilën është detyruar e paditura t'ia paguaj paditëses për dhembje fizike, **vërtetohet**.

**Ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.1148/2015 i datës 20.01.2017, dhe gjykohet:

**Detyrohet** e paditura BKS, që paditëses B. D., në emër të shpërblimit të dëmit jo material (të pësuar si pasojë e aksidentit në komunikacion të dt.16.10.2015), për frikë, t'i paguaj shumën prej 3.500 euro, për dhembje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor t'i paguaj shumën prej 2.000 euro, si dhe për shëmtim trupor, shumën prej 2.500 €, ndërsa përtej shumës së gjykuar, për këto forma të dëmit, kërkesëpadia e paditëses kundër të paditurës, si dhe kamatëvonesa në këtë pjesë **refuzohet si pathemeltë**.

**Ndryshohet** vendimi për shpenzimet procedurale dhe gjykohet: Detyrohet e paditura BKS që për shpenzimet procedurale, paditëses B. D., t'i paguaj shumën prej 1.386 €, ndërsa përtej shumës së gjykuar, e në shumën prej 674 €, kërkesa e paditëses kundër të paditurës, refuzohet si e **pathemeltë**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin e saj C.nr.1148/2015 i datës 20.01.2017, ka vendosur si vijon:

“Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditëses: B. (G.) D., fshati Vitomericë, Komuna e Pejës.

Detyrohet e paditura Byroja e Sigurimeve në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës” p.nr., që paditëses B. (G.) D., fshti ...., në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugorë të dt. 16.10.2015, nga baza e auto- përgjegjësisë, t'ia paguaj shumën e specifikuar si më poshtë dhe atë:

Në emër të dëmit jo material

Për dhembje të përjetuara fizike të intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët, shumën prej 4.000,00 €,

- Për frikë të përjetuar të intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët, shumën prej 2.000,00 €,

- Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm për jetë shumën prej 10.000,00 €, Shëmtim 5000,00 €.

Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve n Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës, që paditëses B. (G.) D., fshati ..., ti paguaj prestimet si në pika II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 18.01.2017, e deri në pagesën e fundit, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë, rr. "Lidhja e Pejës, që paditëses B. (G.) D., fshati ..., t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2.060,00 € (Dymijë e gjashtëdhjetë euro), të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses B. (G.) D., fshati ..., përtej pjesës aprovuese si në pikën II dhe IV, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, refuzohet si e pa bazuar".

Kundër këtij aktgjykimi ndërgjyqësit brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.*

Kompetenca e Gjykatës së Apelit: Kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave të lëndës vlerësoi se ka juridiksion që në procedurë sipas ankesave të shqyrtoi çështjen dhe të jep vendim. Kompetenca e saj në këtë rast bazohet në nenet 22 e 23 të Ligjit për Gjykatat, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 22/2018").

Shqyrtimi i lejueshmërisë së ankesave: Kolegji, para se të shqyrtoj themelësinë e ankesave paraprakisht në bazë të nenit 196 të LPK, shqyrton se ankesat janë të pranueshme në raport me atë se a janë paraqitur brenda afatit ligjor, a janë të lejueshme dhe a i përmbajnë elementet e parapara me ligj.

Sa i përket afatit për paraqitjen e ankesave: Me nenin 176 të LPK, është përcaktuar se: Kundër aktgjykimit të dhënë në shkallë të parë, palët mund të bëjnë ankim brenda 15 ditësh, nga dita kur palëve u dorëzohet kopja e aktgjykimit përkatës.

Nga shkresat e lëndës (Fletë kthesa mbi dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë palës ankuese, si dhe vula e pranimit e dhënë nga gjykata e shkallës së parë në kopje të ankesave) rezulton se ankesat janë paraqitur brenda afatit ligjor, janë të lejueshme dhe janë të plota, pra i përmbushin kërkesat ligjore për procedim lidhur me themelësinë e tyre.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesa dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

*Ankesat pjesërisht janë të themelta.*

*Sa i përket pjesës ndryshuese të aktgjykimit të shkallës së parë:*

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182 par.2 nën par. b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe nuk ekzistojnë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 197 i LPK.

Nga gjendja në shkresa rezulton se gjykata e shkallës së parë ka marrë provat e përshkuara në arsyetimin e aktgjykimit ankimor dhe ka konstatuar gjendjen faktike si vijon:

Se me datën 16.10.2015, në rrugën Istog- Pejë, në fashitin ....., aferë Shkollës fillore, kishte ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin paditësja B. D., kishte pësuar lëndime të rënda trupore, si pasojë e të cilave ka përjetuar dhembje fizike dhe frikë, si dhe dhembje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shkallën prej 5%, si dhe shëmtim trupor të shkallës së rëndë.

*Aksidenti ishte shkaktuar, nga drejtuesi dhe vetura e paidentifikuar.*

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, me arsyetim se janë përmbushur kërkesat ligjore nga nenet 159,183 dhe 382 i LMD, si dhe neni 20 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësi.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i paditëses në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor, është dhënë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material nuk përfaqësojnë satisfaksion adekuat me natyrën e lëndimeve dhe pasojat që ka pësuar pala paditëse. Gjithashtu edhe vendimi për shpenzimet gjyqësore është i pa drejtë, sepse ai nuk përfshinë shpenzimet për taksë gjyqësore për aktgjykim.

Në mbështetje të ankesës nuk ka paparaqitur fakte e as nuk ka propozuar prova të reja.

Përfaqësuesi i të paditurës në ankesë ka pohuar se shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material janë të larta sepse shumat e gjykuara janë në kundërshtim me praktikën gjyqësore sepse janë gjykuar shuma më të larta duke marr parasysh natyrën e lëndimeve trupore si dhe qëllimin e kompensimit, që përfaqëson zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pra dispozitave ligjore të neneve 178, 183, 186, 200, 376, 277, 195 e 190 të LMD.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë sipas barrës së provës, drejtë dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike, por gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e gjykimit në emër të shpërblimit të dëmit jo material për dhembje fizike kur e ka obliguar të paditurën që paditëses t'i paguaj shumën e caktuar si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor, sepse paditësja si pasojë e ngjarjes aksidentale kishte pësuar lëndime të rënda trupore, si pasojë e të cilave kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit dhe kohëzgjatjes së përcaktuar nga mjekët ekspert. Shuma e gjykuar është përcaktuar në përputhje me kriteret ligjore, si dhe praktikën gjyqësore të krijuara nga gjykatat në Kosovë për këtë formë të shpërblimit të dëmit.

Kolegji, vlerëson, se aktgjykimi ankimor në pjesën që ka të bëjë me vendimmarrje lidhur me shumat e gjykuara të cilat e paditura është obliguar t'ia paguaj paditëses në emër të frikës, dhembjeve shpirtërore: për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shkallë 5% si dhe shëmtim trupor të shkallës së rëndë, në këtë pjesë të vendimmarrjes, gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale.

Andaj, kolegji vlerëson se sipas bazës ligjore të nenit 201 të LPK, janë plotësuar kushtet ligjore se aktgjykimi ankimor, në këtë pjesë të ndryshohet.

Me nenin 183 të të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i publikuar “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.16 me dt.19.06. 2012, ( i cili konsiderohet se ka hyrë në fuqi me dt.20 dhjetor 2012), më tej LMD në fuqi, është përcaktuar:

Për dhembjet e pësura fizike, për dhembjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit dhe frikës, e sidomos intensiteti i dhembjeve dhe frikës si dhe kohëzgjatja e tyre, e arsyetojnë këtë, gjykata do të gjykoj shpërblimin e drejtë në të holla, duke u kujdesur për rendësin e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim.

Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara si dhe frikës së të dëmtuarës, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit, që në këtë rast paditësja i ka pësuar në ngjarjen aksidentale.

Kolegji duke marrë për bazë, intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të paditëses, si dhe dhembjet shpirtërore për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shkallën prej 5%, dhe shëmtimin e rëndë trupor, moshën dhe gjininë e të dëmtuarës, si dhe praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykata në Kosovë, vlerëson se shumata e gjykuara në pjesën ndryshuese të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, përfaqësojnë shpërblim të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore të nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i publikuar “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.16 me dt.19.06. 2012, i cili konsiderohet se ka hyrë në fuqi me dt.20 dhjetor 2012.

Me nenin 20 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. 04/L-018 është përcaktuar:”Personi fizik i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi nga përdorimi i mjetit motorik të paidentifikuar, ka të drejtë të parashtrojë kërkesën për dëmshpërblim Byrosë.

Pra, në këtë rast legjitimiteti pasiv i të paditurës buron nga baza ligjore e nenit 20 të ligjit të lart cituar, sepse në rastin konkret paditëses ditën kritike, dëmi i është shkaktuar nga mjete motorik, i pa identifikuar.

Kolegji, konsideron se shumet e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 i LMD, si dhe në kuadër të kornizave të praktikës gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Kolegji, duke u bazuar në dispozitat ligjore të neneve 452.2, 452.5 e 453 të LPK, e ndryshoi aktgjykimin ankimor në pjesën që ka të bëjë me vendimin për shpenzimet procedurale, duke llogaritur në atë rast, shpenzimet gjyqësore sipas numrit tarifor 6 të tarifës së Odës së Avokatëve, duke marrë për bazë, se në rastin konkret kemi të bëjmë me kontest të vlerës mbi 10.000,00 €, e që shuma për një përfaqësim është 160 €, e për tri seanca në emër të përfaqësimit rezulton të jetë shuma prej 480 €, për padi 160 €, për një parashtrësë 104 €, për përpilimin e padisë gjithashtu shuma prej 160 €, taksë gjyqësore për padi, pala paditëse ka paguar 502 €, (Dëftesa në shkresë) kurse për aktgjykim nuk ka prova në shkresat e lëndës se është paguar taksa gjyqësore, për ekspertizë shuma prej 140 €, e në shumë të përgjithshme prej 1.386,00 €.

Më sa u tha më lartë e duke u bazuar në nenet 200 e 201 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË**

**CA.nr.1601/2017 dt. 09.02.2021**

**Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari**

**Gani Avdiu**